



YMETI ISLAM,
YMET I PËRPARIMIT



PUSHTETI ËSHTË AMANET
DHE PËRGJEGJËSI



SHEJTANI ËSHTË ARMIKU
KRYESOR I NJERIUT

UDHA ISLAME

Viti 18 - Nr. 9 (211), Shtator, 2020

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

ISLAMI NA EDUKON E NA FRYMËZON

*drejt paqtlimit
dhe rrugëve të tij*

Le të punojmë me sa të kemi mundësi për të jetuar në paqe dhe në harmoni me njëri-tjetrin, duke ruajtur mbi të gjitha dinjitetin dhe krenarinë e besimit dhe të fesë, shenjtërinë e jetës dhe atë të njeriut-mëkëmbës i Zotit në tokë, dijes dhe arsimimit!





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

YMETI ISLAM, YMET I PËRPARIMIT

gjithësisë për ditën dhe për natën, pra për jetën, për kohën! Për t'i thënë çfarë? Për t'i thënë se *Zoti yt nuk ka hequr dorë prej teje dhe nuk të ka braktisur*. Pastaj i thotë në ajetin vijues (ajeti 4 i sures Ed-Duha): “Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para!”

Pra, përtej madhërimit që të kam bërë, përtej nderimit që të kam bërë, përtej pozitës së lartë që të kam dhënë, përtej gradëve të larta që të kam dhënë dhe, (nuk ia kam dhënë askujt tjetër, përveç tejet, o i dashtuni im Muhammed); dije se ajo që vjen dhe ajo që të pret në të përtejmen është shumë më e madhe dhe shumë më e mirë sesa ajo që kaloi!

Kjo është pozita e Pejgamberit tonë (alejhis-salatu ves-selam), kjo është pozita e Hz. Muhammedit (a.s.), o ymeti i më të mirit Pejgamber!

Mirëpo, ejani të ndalemi paksa tek kuptimet e këtij ajeti: “*Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty*”.

Do të thotë se Zoti i gjithësisë e mëson Pejgamberin (a.s.) dhe na nxit ne nëpërmjet mësimi të tij, që të mendojmë për të ardhmen, e të planifikojmë për të ardhmen! T'i përsosim të gjitha veprat tona, duke i vendosur në shinat e drejta që shpjen drejt së ardhmes së garantuar, drejt ahiretit!

Që do të thotë se Zoti i gjithësisë po na mëson nëpërmjet dashnisë së Tij për Pejgamberin (a.s.), që veprat tona dhe puna e angazhimi ynë, të jenë për një qëllim shumë fisnik dhe shumë të lartë që është fitimi i pëlqimit të All-llahut dhe të menduarit për të ardhmen, për ahiretin; mbi bazat e një jete dhe veprë të shëndoshë!

Sepse, ai i cili punon dhe vepron vetëm për të sotmen dhe nuk i bën llogaritë e të nesërmes, është dritëshkurtër!

Ymeti i Hz. Muhammedit (a.s.), është ymet i planifikimit dhe ymet që e di shumë mirë që e ardhmja e tij është më e mirë sesa e sotmja. Mirëpo, a do të thotë kjo që ne të heqim dorë nga kjo botë? Jo! Përkundrazi, All-llahu (xh.sh.) në krye të herës, na thotë se e ardhmja, ajo është e përjetshmja. Por, kur na ka sjellë në këtë botë na ka ftuar të punojmë për këtë jetë e këtë botë

me sa të kemi mundësi, duke ndërtuar shembuj udhëzimi!

Prandaj, nuk i shkon mëkëmbësit të All-llahut (xh.sh.), me qenë njeri përtac, njeri parazit, njeri i paformuar, njeri i pazhvilluar ai dhe ekonomia dhe realitetet e tij, njeri i zhytur në injorancë! Nuk i shkon atij!

YMETI I Hz. MUHAMMEDIT (A.S.), ËSHTË YMET I PLANIFIKIMIT DHE YMET QË E DI SHUMË MIRË QË E ARDHMJA E TIJ ËSHTË MË E MIRË SESA E SOTMJA. MIRËPO, A DO TË THOTË KJO QË NE TË HEQIM DORË NGA KJO BOTË? Jo! Përkundrazi, All-llahu (xh.sh.) në krye të herës, NA THOTË SE E ARDHMJA, AJO ËSHTË E PËRJETSHMJA.

POR, KUR NA KA SJELLË NË KËTË BOTË NA KA BËRË MËKËMBËSIT E TIJ DHE NA KA FTUAR TË PUNOJMË PËR KËTË JETË E KËTË BOTË ME SA TË KEMI MUNDËSI, DUKE NDËRTUAR SHEMBUI UDHËZIMI!

Përkundrazi, ymeti islam është: “Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë”², që do të thotë, të jesh i fortë me dije, të jesh i fortë me ekonomi, të jesh i fortë si pozitë shoqërore, të jesh i fortë në çdo fushë dhe në çdo drejtim të jetës! Mos të jesh ti bishti i shoqërisë tënde, por të jesh në krye të shoqërisë me vlerat tuaja, me besimin tënd! Pra, ta përdorësh besimin tënd dhe të të shërbejë besimi jot për çdo gjë drejt së cilës të ka ftuar Zoti në jetë!

Mua më ka ftuar drejt këtij minberi, ty të ka ftuar drejt biznesit, atë e ka ftuar drejt futbollit, atë tjetrin e ka ftuar drejt mjekësisë, atë drejt politikës, dikë

2. Kur’ani, EL-Bekare: 201.

drejt tregtisë, atë tjetrin drejt artit, atë në një fushë tjetër, këtë inxhinier të informatikës! Secili të dëshmojë më të mirën, sepse është ymeti i Hz. Muhammedit (a.s.)!

Dhe nuk i shkon pasuesve të Hz. Muhammedit (a.s.) me qenë njerëz me kokë të ulur, as njerëz të përlulur, a njerëz të përbuzur, as njerëz të dorës së dytë në realitetet e shoqërive të tyre!

Për këtë, ne kemi refuzuar dhe refuzojmë herë pas here me tonet më të larta dhe pa pyetur për reagimet e askujt në botë, pa vënë në peshore reagimet e askujt që mund mos t'i pëlqejë reagimi ynë, kur kemi ngritur zërin për padrejtësitë e panumërta, që bëhen në realitetet e qytetit tonë dhe të vendit tonë, me nëpërkëmbjen e Islamit dhe muslimanëve!

ASKUSH NUK DUHET TË GUXOJË TË MENDOJË T'I THOTË TJETRIT: “JE I SHKARKUAR NGA DETYRA SE TI JE MUSLIMAN!”, “**NUK PRANOHEH NË PUNË, SEPSE TI JE MUSLIMAN!”**”, “**NUK PRANOHEH SI MËSUESE, SEPSE JE ME HIXHABI!”**”, “**NUK PRANOHEH STUDENTE, SEPSE JE ME HIXHABI!”**”, **ETJ! NUK E PRANOJMË NE KËTË GJUHË DHE DUHET TË PUNOJMË ME ÇDO MUNDËSI LEGJITIME PËR TA PASTRUAR VENDIN NGA KJO FRYMË RACISTE DHE NGA KJO SJELLJE E PADENJË PËR NJË KOMUNITET A BASHKËSI NJERËZISH TË QYTETËRUAR!**

Duhet ta refuzojmë këtë gjuhë! Kjo është gjuha e tiranive dhe e mesjetës! Dhe në mesjetë, ju e dini se cili ka qenë realiteti i botës. Mesjeta është kancer i historisë së njerëzimit! Mesjeta e këtij kontinenti ku ne jetojmë! Nuk duhet të pranojmë të na rikthehet mendësia e

mesjetës nëpërmjet altoparlantëve të ndryshëm dhe kakofonisë së disave kundër Islamit dhe myslihanëve! Ia kthejmë mbrapsht kujtdo qoftë në botë! Sepse me krenarinë legjitime të besimit dhe dinjitetit islam, ne na shndrit Kur’ani, na shndrit jeta e Pejgamberit (a.s.), na shndrit historia e jonë, na shndrit çdo hap që hedhim në jetë si besimtarë! E sa më tepër që kapemi pas fesë tonë aq më tepër bëhen të fortë, të qëndrueshëm, e të palëkundshëm hapat tonë në jetë!

E gjithë kjo, për të mirën e jetës, për të mirën e shoqërisë, për të mirën e njerëzimit, pa asnjë dallim në mesin e tyre!

Përgjatë historisë, sot e mot, ne nuk mund të dalim të dashurit e mi, jashtë kufijve të dritës së besimit e të fesë tonë! Ne nuk mund të dalim, sado që të filozofojmë, e sado që të na duken të bukura politikat e tradhtisë ndaj fesë, politikat e zhveshjes nga morali i fesë, politikat e heqjes së gjetes së fundit që mbulon lakuriqësinë! Sado që të krijojnë mirazhe iluzive dinakëria dhe zigzagjet, e sado që të ketë edhe thirrës a propagandues me të madhe të këtyre frymërave të lakuriqësimi! Ne nuk mund të dalim përtej thirrjes së Kur’anit Famëlartë, se është fjala e Zotit!

Dhe kur Zoti i gjithësisë thotë se: “Pa dyshim feja te All-llahu është Islami. U kundërshtuan ata që u është dhënë libri, pasi që u erdhi e vërteta, nga zilia mes vete. E kush mohon argumentet e All-llahut, (le ta dijë se) All-llahu (ia) llogaritë shpejtë”³, a kur Zoti i gjithësisë thotë: “Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur’anin) e vërtetë që

3. Kur’ani, Ali Imran: 19.

është vërtetues i librave të mëparshme dhe garantues i tyre. Gjyko, pra, mes tyre me atë që All-llahu e zbriti, e mos pëlqe epshtet e tyre e të largohesh nga e vërteta që i erdhi. Për secilin prej jush, Ne caktuam ligje program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte All-llahu, do t’ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t’ju sprovovë në atë që iu dha juve, andaj ju (besimtarë) përpikuni për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është te All-llahu, e Ai do t’ju njoftojë me atë që kundërshtoheshi”⁴. Pra, Kur’ani është mbrojtës i tyre, reflektues i tyre, rrezatues i tyre; ne do shkojmë pas thirrjes së Kur’anit, të dashurit e mi!

Kemi harruar ne se kush ishte Faraoni? Kemi harruar ne se kush ishte Karuni? A i lexojmë historitë e Kur’anit thjeshtë për të lexuar disa ngjarje të së kaluarës së largët? Apo për të marrë mësim nga historitë e pejgamberëve të mëparshëm? Si për të na thënë Zoti i gjithësisë, mos u bëni si ata! Mos u bëni si të kaluarit, o ymeti i më të Mirit!

Allahu (xh.sh.) na nxit që të posedojmë forcën, që të posedojmë pushtetin, që të posedojmë shoqëri të shëndosha dhe të forta, të gatshme për çdo sfidë në jetë, sepse jeta është plot sfida! Jo shoqëri që e kanë përherë kurrizin e thyer, e kanë përherë kokën e ulur, se ai që e ka kokën e ulur, nuk është në gjendje të nënshkruajë as për paqen, as për tolerancën, as për harmoninë, as për bashkëjetesën.

Ymeti islam nuk është ymeti i këtij diktati, të dashurit e mi! Nëse nuk e kuptojmë këtë, do të thotë se ne kemi një problem shumë të madh me

4. Kur’ani, EL-Maide: 48.



botëkuptimin e fesë sonë!

Nëse nuk e kuptojmë siç duhet duke lexuar këto ajete kur'anore të sures Duha, do të thotë se ne kemi një problem të madh në Islamin tonë, pra me leximin e Islamit tonë, do të thotë se nuk e kuptojmë fenë tonë.

Nëse na ngelet feja vetëm me këto predikime brenda katër mureve të xhamisë dhe pastaj selam alejkum, alejkum selam, të xhumanë tjetër, kjo nuk është esenca e kësaj Thirrje!

TË DASHURIT E MI!

Duke e ndjekur rrugën e ajetit të katërt të sures Duha, kur All-llahu (xh. xh.) i thotë Pejgamberit se e ardhmja është më e mirë, pra ahireti është më i mirë sesa e sotmja, ne edukohemi si shoqëri të ruhem nga faraonizimi, në momentin kur kemi një pushtet në dorë, dhe nga kopraccia kur kemi pasuri në dorë.

Modeli ynë është Hz. Ebu Bekri, modeli ynë është Hz. Omeri, modeli ynë është Hz. Osmani, modelet tona janë sahabët e Pejgamberit (a.s.), që çdo gjë që e kishin, e kishin në dorën e tyre, jo në zemrën e tyre!

Për këtë, dua ja më e mirë që duhet të bëjë muslimani është: *All-llahumme na e jep këtë botë dhe pasuritë e saj në dorën tonë, nëse është hajr për ne dhe, largoje atë nga zemra e jonë!*

Se po të hyri pasuria e dëshira e pozitës, e pushtetit dhe e forcës në zemër, ta shkatërron atë dhe të shkatërron edhe ty si njeri!

Atëherë pyetja është: Personi që nuk e ka dhënë zekatin dhe nuk e ndan zekatin e pasurisë së tij, a beson ai realisht në ajetin e katërt të sures Ed-Duha: "Ajo që vjen është më e mirë sesa e sotmja për ty"?

Ai që frenohet për të ndarë zekatin, për të ndihmuar njerëzit në nevojë, për të ndihmuar komunitetin e tij, familjarët e tij, e kështu me radhë... A është ai besimtar në këtë mirësi të Zotit të gjithësisë për pejgamberin tonë dhe për ymetin e tij deri në ditën e fundit? Apo është zhytur në detrat e koprracisë, njëkohë që koprracia buron nga shejtani i mallkuar?!

Tjetër. Ai që grabit, që vjedh, që

shantazhon, që dhunon, që korruptohet, që korrupton, që lëshohet në botën e haramëve, por ndoshta ka e mjekrën më të madhe se mjekra ime, ai ka problem shumë të madh, me kuptimin e këtij ajeti: "E ardhmja është shumë më e mirë për ty sesa e sotmja"!

Ai është i zhytur në llumin e mohimit real edhe faktik të këtij ajeti kur'anor!

Për këtë të dashurit e mi, urdhëresa për të mirë dhe ndalimi i të keqes në shoqërinë tonë islame në jetën e myslimanit, konsiderohet si rregulli i gjashtë apo shtylla e gjashtë e fesë islame!

Sepse shoqëria jonë islame, është shoqëri që e shfrytëzon të sotmen për ta zhvilluar jetën, me besimin e patundur në të përtejmen dhe me përkushtimin për të dalë faqebardhë përpara Zotit të gjithësisë. Atëherë, ajo që bëjmë, po të na merret shpirti në këtë moment, a do të na bëjë që të dalim faqebardhë përpara Zotit të gjithësisë?

TË MENDOJMË PAKSA, NËSE PEJGAMBERI (A.S.) LAVDËRON HZ. EBU TALHANË PËR ZËRIN E TIJ NË USHTRI, PËR ÇFARË LËVDOHESH TI SOT NË REALITETET E JETËS TËNDE? A LËVDOHESH TI PËR DIJEN TËNDE? A JE TI MË I DIJSHËM DHE MË I PËRKUSHTUAR PËR DIJEN SESA KREJT SHOQËRIA JOTE? A JE TI MË I SPIKATURI DHE MË I ANGAZHUARI NË FUSHËN QË TË KA VENDOSUR ZOTI NË JETË DHE TË KA THIRRUR DREJT SAJ? APO JE NJË NJERI I RËNDOMTË?

PEJGAMBERI (A.S.) ËSHTË DUKE KËRKUAR PREJ MUSLIMANIT QË TË JETË ASHTU SIKURSE KA THËNË SHPESH HERË: "NISHAN, NË SHOQËRINË E TIJ!"

TË DASHURIT E MI,

Pejgamberi (a.s.) na tregon për një sahabi të nderuar, i cili quhet Zejd ibni Sehel (r.a.), ose ndryshe Ebu Talha El-Ensari (r.a.).

Ebu Talha ishte një person për të cilin Pejgamberi dëshmoi dhe tha: "Zëri i Ebu Talhasë në ushtri, është më i mirë sesa zëri i një grupi të tërë!"

Të mendojmë paksa! Nëse Pejgamberi (a.s.) lavdëron Hz. Ebu Talhanë për zërin e tij në ushtri, për çfarë lëvdohesh ti sot në realitetet e jetës tënde? A lëvdohesh ti për dijen tënde? A je ti më i dijshëm dhe më i përkushtuar për dijen, sesa krejt shoqëria jote? A je ti më i spikaturi dhe më i angazhuari në fushën që të ka vendosur Zoti në jetë dhe të ka thirrur drejt saj? Apo je një njeri i rëndomtë?

Pejgamberi (a.s.) është duke kërkuar prej muslimanit që të jetë ashtu sikurse ka thënë shpesh herë: "Nishan, në shoqërinë e tij"!

A jemi ne shoqëri me individë muslimanë nishan? Në realitetet e Shkodrës, fjala bie... (dhe të zgjerohemi kështu në rang Shqipërie, rajoni dhe përtej...).

Kjo është sfida! Po në dhikrin tënd? Po në adhurimin tënd? Po në tregtinë tënde? Po në marrëdhënie me gjuhën? Po në marrëdhënie me zemrën? Po në marrëdhënie me mendimet, a je ti më i miri? Ose më i mirë sesa një grup i tërë? Pyete veten, kjo është sfida e këtij mesazhi, për mua të parin, edhe për ju së bashku!

All-llahu (xh.sh.) na tregon shembullin e Hz. Ibrahimit (a.s.), e krahason Hz. Ibrahimin (a.s.) dhe shembullin e tij në besim *me një ymet të tërë, sa një ymet i tërë!* Pra, Hz. Ibrahim (a.s.) peshon tek All-llahu sa një ymet i tërë. Ti si musliman sa peshon në

realitetet tuaja? Ti si mjek musliman, ti si inxhinier musliman, ti si arkitekt musliman, ti si deputet musliman, ti si politikbërës i këtij vendi musliman, sa peshon? Ti si imam, ti si myfti, ti si..., sa peshon?

Nëse Hz. Ibrahim (a.s.) peshon sa një ymet, e nëse zëri i Talhasë peshon sa një ushtri, ti sa peshon?

"Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para."

Imam Ebu Mensur El-Maturidi, në tefsirin e këtij ajeti shkruan: "Me gjithë çfarë të kam dhënë në këtë botë, o Muhammed (a.s.), prej pozitës së lartë, prej përmendjes së madhe dhe triumfit ndaj faraonëve, dije se ahireti, është më i mirë për ty sesa ajo që kaloi. E bëri këtë duke e mësuar Pejgamberin (a.s.) dhe duke e nxitur të jetë sa më zahid në këtë botë..."

Kur ajo zemër që është gatuar me dashninë e All-llahut (xh.sh.) ndriçon dhe lulëzon çdo ditë me përmendjen e Tij, dijeni se do ta marrë për dore të zotit e saj drejt më të mirave jo drejt më të mirës!

(Hytheja e xhumasë, më 18 shtator 2020, në xhaminë e Parrucës)

GRATË MUSLIMANE TË ANDALUZISË - PROFESIONET E TYRE

Gratë muslimane në Andaluzi përgjatë shekujve 8-15 ishin shumë të arsimuara, ashtu si pjesa tjetër e shoqërisë. Për fat të keq nuk ka shumë shkrime rreth tyre në librat e historisë dhe as biografi, gjë që e bën vërtet të vështirë gjetjen e informacionit rreth tyre¹, por kjo nuk do të thotë që gratë myslimane nuk gëzonin liri ose arsimim. Në fakt, ato ishin ndër gratë më të arsimuara dhe më të respektuara të kohës së tyre (në pjesën tjetër të botës, gruaja as nuk konsiderohej qenie njerëzore).

Gratë në Andaluzi gjatë periudhës së artë islame jo vetëm që punonin si shtëpiake, por edhe ne punë që sillnin përfitime financiare dhe që mund të kryeshin si brenda edhe jashtë shtëpisë. Islami i bën thirrje si femrave ashtu dhe meshkujve që të lulëzojnë dhe të rriten shpirtërisht, profesionalisht dhe personalisht në të gjitha aspektet e jetës.

1. "KATIBAH" SHKRIMTARE

Ishte një nga punët më të përhapura, sipas el-Murrakushi :në lindje të Kordobës (Kryeqyteti i Kalifatit) ndodheshin 170 gra që e shkruanin Kuranin me shkrim Kufi. Kjo ishte vetëm në lindje të Kordobës. Disa nga këto shkrimtare kishin pozita të rëndësishme si Luba e Kordobës, shkrimtarja e Kalift El Hakam i dytë.

Lubna kishte dije të gjerë të gramatikës dhe ishte poete, matematikane dhe kaligrafe. Pavarësisht disavantazheve të saj sociale(ishte skllave) ajo drejtonte një librari me 500.000 libra, udhëtoi në Lindjen e Mesme për të shtuar më shumë libra, duke u bërë kështu një nga femrat e para që udhëtuan vetëm.

2. "KABILAH" MAMIE

Një nga profesionet më të përhapura tek gratë ishte mamia, edhe pse në raste më të vështira kërkoheshin mamie më të specializuara. Kjo punë paguhej shumë mirë. Mamitë jo vetëm që asistonin gjatë lindjes, por shërbimi i tyre shtrihej edhe në aspekte ligjore, si për shembull për të dëshmuar nëse një fëmijë kishte vdekur gjatë lindjes apo për të vërtetuar nëse gruaja ka qenë apo jo shtatzënë. Të dy

1. Shënim i redaksisë: Në fakt, ka plot tituj studimesh, veprash e konferencash shkencore rreth kësaj teme.

rastet janë të lidhura me të drejtën e trashëgimisë.

3. "TABIBAH" MJEKE

Përveç asistimit në lindje, gratë kanë spikatur edhe në fushën e mjekësisë veçanërisht në kurimin e të sëmurëve. Disa burime përmendin historinë e El-Hafidh Ibn Zahr, një doktori të famshëm që kishte një motër dhe një nip me eksperiencë në mjekësi dhe që shëronin njerëz. Ata shkonin në pallatin e Kalift El-Mensur për të shëruar gratë dhe njëerë prej tyre i merreshin këshilla për kurimin e sëmundjeve të meshkujve.

4. "ADIBAH" MËSUESE (EDUKATORE)

Gratë që punonin si mësuese njiheshin si "adiba".

Ato mësonin Kur'anin (mu'addibat al-Qur'an) zakonisht vajzave dhe grave, por gjithashtu edhe meshkujve. Sajjida Bint 'Abd Al-Gani Ibn Ali jepte mësim



8. "FAKIHA" JURISTE

Shumë gra kanë marrë edukim të avancuar dhe trajnime të larta në Andaluzi në shkencat islame. Një shembull është gruaja e Kadisë së Lojas. Ajo shquhej për diturinë e saj për sa i përket drejtësisë dhe ia kalonte dijetarëve në njohjen e vendimeve gjyqësore dhe çështjeve ligjore; burri i saj, gjyqtar, e pyeste atë rreth dënimeve. Shumë talleshin me

të, sa një poet thotë: "Në Loja, ndodhet një Kadi i cili ka një grua dhe mendimet e saj midis njerëzve janë më efektive. Do të doja që ai të mos ishte Kadi, por ajo!" Fjalë të cilave e shoqja ju përgjigj me vargje të tjera.


9. "ALIMAT AL FALAK" ASTRONOME

Ka patur shumë astronome në Andaluzi, por fatkeqësisht gratë rrallë përmenden në libra historikë apo biografikë. Një astronome, e cila ishte skllave e Hakamit të Dytë, shërbyese në pallat ishte lënë në dorëzim nga vetë kalifi te një astronom për ta mësuar atë. Pas tre vitesh ajo u bë një eksperte në fushën e astronomisë dhe u kthye në pallat për të punuar si astronome.

(Artikulli është marrë nga faqe e blogeres Fátima de Tetuán, Spanjë)

Përktheu nga anglishtja:

Indira Krymi



Sheikh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

Pushteti në Islam është amanet i rëndë, ku trimat frikësohen prej tij e, si atëherë ia ngulin sytë të dobët. Ai, pushteti, nuk është çmenduri e të mëdhenjve kur duan sundimin dhe as mburrje e mendjemadhësi, pa pasur parasysh se kjo mburrje është fryt i aftësisë së personit, apo fryt i gjendjes së sëmure! Pushteti është përgjegjësi e madhe para Zotit. Udhëheqësi është argat tek populli mysliman, ruan interesat e tyre fetare e jofetare si kompensim, përballë pagës që merr.

Le të shkëpusim diçka prej historisë së Ebu Bekrit (r.a) e të Omerit (r.a), që na e bënë të qartë domethënien e asaj që përmendëm më lart e na zbulojnë në përgjithësi politikën e pasurisë dhe pushtetit në Islam. Ja se çfarë i ka thënë Ebu Bekri nënës së besimtarëve Aishes në prag të vdekjes së tij:

“E mora përsipër drejtimin e këtyre njerëzve në kohën kur kthimi prapa ishte humbje e zhgënjimi ishte teprim”, d.m.th se, ai nuk e kërkoj kalifatën e as që e donte atë, por e ndjeu se trembja nga pranimi i pushtetit të shfaqur do ta ekspozonte ymetin për shumë prova të mëdha. Për këtë ai thotë “Dëshmitari im është All-llahu, i Cili nuk më la të ikja nga kalifati, nuk pranoi dorëheqjen time”.

Ebu Bekri tregon se si ai nuk ka marrë dhe nuk ka përfutur pagë nga pasuria e popullit, përveçse fare pak, një enë me qumësht deveje që i ishte caktuar nga pasuria e shtetit dhe thoshte: “Haja prej anës së tyre, pija nga gjiri i devesë dhe falja me ta namazin, jo mendjemadh arrogant e as shumues e bukëshkalë!! Nuk e teproja, vetëm sa për të larguar urinë, mbuluar avretin dhe të ushqeja trupin! Vetëm sa të jetoja prej ushqimit e të mbaja gjallë frymën”. Pastaj betohet në Zot se, ai u detyrua të

PUSHTETI ËSHTË AMANET DHE PËRGJEGJËSI

hante prej pasurisë së shtetit, sa për të larguar urinë, për shkak të dobësisë së ushqimit të keq që hante! Por siç dihet nevojtar i pi edhe të hidhurën!

Shprehja e tij ishte: “Zoti dëshmon për urinë e dhimbshme që mbanin të përbrendshmet e mia dhe për këtë u detyrova, siç detyrohet i sëmuri të pijë ujë të njelmët”. Pastaj, kalifi në prag të vdekjes, ia lë amanet bijës së tij që t’ia kthejë myslimanëve atë çka ka marrë prej pasurisë së tyre. Për këtë ai thotë: “Kur të vdes, ktheju nënën e tyre, shërbëtorin, devenë, petkun që mbrohesha prej të ftohtit dhe petkun tjetër që ruhesha nga balta e tokës”. Shtrati që flinte Ebu Bekri, kalifi i myslimanëve ishte i shtruar me gjethe hurme!

Sheikh Huderij thotë: “Ebu Bekri e konsideronte veten, si ai që s’ka të drejtë në pasurinë e shtetit, sipas veprës së tij, për këtë la amanet që tokën e tij t’ia jepte myslimanëve si kompensim të asaj që kishte marrë prej tyre”.

Ndërsa, sprovat e tij të gjata në forcimin e themeleve të Islamit, para murtedëve¹ dhe përgatitja e tij e rrallë në luftën kundër persëve e romakëve, janë sakrifica e robrit, i cili kërkon kënaqësinë e Allahut dhe nuk kërkon shpërblim për të. Duket qartë se kalifi i parë ngarkoi veten e tij me atë që s’ishte ngarkuar, ngaqë sahabet me dëshirën e tyre i kishin caktuar prej pasurisë së popullit, çka me drejtësi e meritonte dhe pa pasur aspak problem në të.

Ibn Seadi në Tabekat² thotë: “Ebu Bekri shpenzonte nga shfrytëzimi i pasurisë së tij dhe nga puna e dorës së tij, vazhdoi në këtë gjendje për disa muaj pas marrjes së kalifatit, duke mos shpenzuar për veten e tij nga pasuria e shtetit.

U ngrit një ditë në mëngjes dhe në krahët e tij mbante disa plaçka, me to po shkonte në treg! E takon Umeri dhe i thotë: “Ku po shkon?” - Për në treg, iu përgjigj Ebu Bekri! Pastaj Umeri i tha: “Çfarë të bësh, ty të është ngarkuar çështja e myslimanëve?” Ebu Bekri tha: “E si të ushqej familjen?” Umeri e këshilloi: “Kthehu, Ebu Ubejde³ do të

caktojë ty nga pasuria e shtetit”.

Kur u kthye, Ebu Ubejde i tha: “Do të jap ushqimin e një burri nga muhaxhirët, jo sa më i miri, e jo sa më i keqi prej tyre, veshje për dimër e verë dhe kur të vjetrohet e kthen të vjetrën e të jap tjetër në vend të saj!”

Aishja (r.a) thotë, siç transmeton Et-Tabariu: “Shtëpia e babait tim ishte te gruaja e tij Habibe Ibnetu Kharixhe, ku kishte bërë një dhomë me gjethe hurme dhe s’kishte më tepër, derisa kaloi në shtëpinë e tij në Medinë. Pas marrjes së besës, që nga koha kur u bë kalif, jetoj edhe gjashtë muaj në këtë dhomë prej gjethe hurme”. Lavdi i qoftë Zotit!

Të gjithë përfaqësuesit e popullit hanë e pinë gjërat më të mira e të shijshme nga pasuria e popullit dhe thonë për fenë se, ajo është opium për popullin e, për udhëheqësit, emirët e besimtarëve myslimanë se, ata kanë grabitur popujt! Sikur ndonjëri prej tyre, të kalonte një natë në dhomën e shtruar me gjethe hurme e të sillej sa në një krah në tjetrin, në shtratin prej kashte që e mbron nga balta e tokës, çfarë do të kishte thënë? A do të kishte mbetur gjë nga thënia e tyre: Feja drogon popullin dhe se kalifët grabisnin popullin? Apo, e di se grabitësit e popullit janë dikush tjetër!!

Në këtë banesë modeste, të thjeshtë jetoj burri, i cili vendosi planin, strategjinë për shporrjen e Herkulit nga Shami njëherë e përgjithmonë dhe shporrjen e Kirsasë nga qyteti i tij, i cili jetonte në kështjellën e bardhë, të cilën Bahteriu⁴ e përshkruante kështu: “Nuk e di, a e ndërtuan njerëzit për xhindet që të banojnë, apo xhindet për njerëzit?!”

Pas Ebu Bekrit, erdhi Umer ibnul-Hatabi, burrë shteti i madh, strateg i luftës e i paqes dhe gjykues i paanshëm në mes popullit e ministrave të tij! Ajo, që na intereson ne këtu, është të shfaqim dy cilësi nga historia e tij e lavdishme:

1- Ndjenja e tij e thellë për përgjegjësinë e pushtetit e shqetësimi i tij për llogarinë para Zotit.

2- Pastaj, refuzimi i tij i prerë për çdo shfrytëzim të pushtetit në favor të vetes apo të familjes së tij!

4. Bahteriu (821-898), poet arab i periudhës abasite.

Në cilësinë e parë, përmendim thënien e njohur të tij: “Sikur një deve të humbte e të ngordhte në brigjet e Eufratit, do kisha pasur frikë se Allahu do të merrte në pyetje për të, familjen e Hatabit”, d.m.th veten e tij. Kjo ngjan përsëri me atë që transmetohet nga ai: “Sikur një mushkë të rrëzohej në Irak, do konsideroja Umerin përgjegjës për të, përse nuk ia ka rregulluar rrugën!”

Nga Ebu Ravaha transmetohet se Umer ibnul-Hatabi i shkroi drejtuesve të tij: “Konsideroni njerëzit të barabartë para drejtësisë, i largëti i tyre si i afërmi dhe i afërmi si i largëti! Mjerë për ju në qoftë se merrni rryshfete, gjykoni sipas epshit, apo t’i gjykoni ata në kohën kur jeni të zemëruar. Bëhuni të drejtë, qoftë edhe vetëm në një orë të ditës”.

Ndërsa një ditë, ligjëroi e tha: “O ju njerëz! Ju më emëruat udhëheqës tuajin, por sikur të mos ishte lutja

e cila mbante erë të mirë, enë uji dhe rroba për gra, ia dorëzoi përfaqësuesve të postës që t’ia shpinin asaj.

Me të mbërritur dhurata, gruaja e mbretit mblodhi gratë e saja dhe u tha: Kjo është dhurata e mbretëreshës arabe, e bijës së Pejgamberit të tyre! I shkroi e i dërgoi edhe ajo një dhuratë, e cila mbante një varëse shumë të çmueshme!

Sapo posta i mbërriti Umerit, urdhëroi për konfiskimin e saj dhe thirri: “Es-Salatu xhamia”⁵! U mblodhën sahabet. Umeri i udhëhoqi në dy rekat namaz, pastaj tha: “Pa dyshim që s’ka mirësi një punë, e cila kryhet pa konsultim. Më thoni, çfarë të bëj me dhuratën që Um Kulthumi i ka dërguar gruas së mbretit të romakëve, e cila pastaj i ka kthyer edhe ajo një dhuratë?”

5. Thirrja që përdoret në Islam për tubimin e njerëzve kur ka, ose ndodh diçka e madhe. Kup-timi i saj, ejani të tubohemi për namaz.

MYSLIMANËT I DHURUAN KËSAJ BOTË NË RANUN INDIVIDUAL, SHOQËROR DHE POLITIK PARIME E SHEMBUJ, TË CILAT MAHNITIN SHIKUESIT DUKE I LËNË ME SY HAPUR. ARABËT NË EPOKËN E MESJETËS NUK LËVIZËN, U NISËN NGA BOSHLLEKU, POR ISLAMI DËRDHI METALIN E ÇMUAR NË KALLËPET E TYRE, PASTAJ I HODHI NË LINDJE E PERËNDIM, DUKE E RIFORMATUAR BOTËN NË NJË FORMË TË RE. POPUJT IA DORËZUAN UDHËHEQJEN E TYRE FESË SË ARDHUR, SEPSE ATA GJETËN TEK AJO SHPËTIMIN DHE KRENARINË E TYRE!

dhe kërkesa juaj ndaj meje, duke më konsideruar si më të zotin në ju dhe për ju, si më të fortin dhe më ekspertin për t’ju përfaqësuar në detyrat dhe përgjegjësitë tuaja, nuk do ta kisha pranuar këtë gjë nga ju. Dhe do t’i kishin mjaftuar Umerit telashet e mërziqet, në pritje të llogarisë për të drejtat tuaja; si merrën dhe ku të vendosen ato? Çfarë udhëheqësi kam qenë për ju? Por, Zoti është Ndihmësi; Umeri tani nuk beson në asnjë forcë apo fuqi, në qoftë se nuk e mbulon Allahu me mëshirën, ndihmën dhe fuqinë e Tij”.

- Ndërsa për largimin e Umerit dhe familjes së tij nga çdo punë, e cila jep erë shpërdorimi të ligjeve, profesor El-Huderij ka thënë: “Kur mbreti romak ndërpreu betejën dhe filloi të diskutojë për paqe, Umeri i shkroi dhe e afroi që ta pranonte paqen, duke i dërguar përfaqësuesit e tij dhe së bashku me ta Umm Kulthum bint Alij ibn Ebi Talib, e cila ishte gruaja e Umerit, dërgon një dhuratë për mbretëreshën e romakëve,

Disa thanë: “Ajo i takon asaj se, edhe ajo i dërgoi një të tillë, d.m.th kompensimi i asaj që i dërgoi dhe gruaja e mbretit nuk është përgjegjëse për çështjet e popullit që kjo gjë të quhet rryshfet”. Të tjerë thanë: “Më përpara ishim që dhuronim rroba që të na dhuronin edhe neve, d.m.th të përfitonim diçka ndoshta më të mirë.” Umeri tha: “Por, përfaqësuesi, i cili e mbarti dhuratën, është përfaqësuesi i myslimanëve dhe posta është posta e tyre”. Pastaj, Umeri shikoi që dhurata e dërguar për gruan e tij ishte shumë e çmueshme dhe se varësja në kraharorin e saj e shqetësonte, për këtë e konfiskoi dhe e vendosi në pasurinë e shtetit, pastaj i dha gruas së tij vlerën e dhuratës që ia kishte dërguar mbretëresha e romakëve.

Sipas historianëve, Umeri ishte person, i cili kur donte të ndalonte njerëzit për diçka, mblidhte familjen e tij dhe i thoshte: “Unë ndalova njerëzit për këtë e për këtë, e ata ju shikojnë

juve sikur shikon skifteri për mish. Betohem në Zot, që sikur të gjej që ndonjëri prej jush bën atë që ndalova, kam për t’ia dyfishuar dënimin”.

Me të vërtetë, Umeri ruajti veten dhe familjen e tij qoftë edhe nga një qindarkë prej pasurisë së shtetit. Ai ishte tamam si kalifi i parë, lodhej e sakrifkonte në shërbim të popullit e të Mesazhit të tij, me besim e vendosmëri tek Allahu.

Myslimanët i dhuruan kësaj botë në rangun personal, shoqëror dhe politik parime e shembuj, të cilat mahnitin shikuesit duke i lënë me sy hapur. Arabët në epokën e mesjetës nuk lëvizën, u nisën nga boshllëku, por Islami derdhi metalin e çmuar në kallëpet e tyre, pastaj i hodhi në lindje e perëndim, duke e riformatuar botën në një formë të re. Popujt ia dorëzuan udhëheqjen e tyre fesë së ardhur, sepse ata gjetën

tek ajo shpëtimin dhe krenarinë e tyre.

Sado që të sektarizohen, të bëhen fanatikë të pafetë, të krishterët e sionistët kundër Islamit, kurrë nuk do të humbasin të vërtetat e mëdha të kësaj feje nga sytë e njerëzve dhe, as që do t’i shuajnë urrejtjet e zezat!

Çfarë ekzistonte tek persianët e romakët, prej formave të pushtetit, të cilat u zbatuan në Medinën e ndritshme? Por, çfarë kishin ata prej veprimeve morale dhe bazave të edukatës? Ishte në interesin e pastër njerëzor, të shembeshin këto perandori të mbaruara, e këta religjione tirane mitologjike dhe të shkëlqente Islami mbi botën, që ta pastronte e ta ngrinte në një rang më të lartë.

(Shkëputur nga libri: “Probleme në rrugën e jetës islame”).

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja



Naim Driaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Në shumë ajete kur'anore shejtani përshkruhet armiku kryesor i njeriut. Allahu i ka bërë të njohura në Kur'an disa vese dhe veçori negative të tij, si mendjemadhësia, refuzimi i urdhrat të Allahut, mosbesimi, ndarja nga xhemati (grupi), zilia, mosbindja, nënçmimi etj.¹

Allahu i Madhëruar thotë: “Me të vërtetë, shejtani është armik i juaji, andaj konsiderojeni edhe ju atë armik!...”² Ebu Hurejre (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Nuk ka foshnjë që lind e që shejtani mos ta prekë atë. Menjëherë pas lindjes foshnja fillon të qajë nga prekja e shejtanit, përveç Merjemes dhe birin të saj (Isait a.s)”.³ Më pas Ebu Hurejra (r.a) tha: “Lexoni (fjalën e Allahut): “Të lutem Ty që ta mbrosh atë dhe pasardhësit e saj nga shejtani i mallkuar!”.^{4,5}

Shejtani i mallkuar që kur lind njeriu e derisa t'i dalë shpirti nuk e lë kurrë të qetë dhe nuk i ndahet për asnjë çast.

Shejtani ka disa qëllime me të cilat ai mundohet që t'i bëjë njerëzit e dëshpëruar

1. Shejtani mundohet që t'i bëjë njerëzit që ta harrojnë Allahun (xh.sh). Allahu i Lartësuar thotë: “Ata i ka vënë poshtë djalli dhe i ka bërë që të harrojnë përmendjen e Allahut”.⁶ Çdo gjë që ty të largon nga Allahu (xh.sh) do të thotë se me këtë shejtani e ka realizuar dhe e ka arritur qëllimin e tij.

2. Nxitja e urrejtjes mes njerëzve në përgjithësi. Allahu i Madhëruar thotë: “Vërtet, shejtani kërkon që të fusë midis

1. Shih: Kur'ani, El-Bekare: 34; El-A'raf: 11; El-Hixhr: 30-31; El-Isra: 61; El-Kehf: 50; TaHa: 116; Sad: 73-74.

2. Kur'ani, El-Fatir: 6.

3. Disa dijetarë kanë thënë se e njëjta gjë vlen edhe për Pejgamberët e tjerë.

4. Kur'ani, Ali Imran: 36.

5. Buhariu dhe Muslimi.

6. Kur'ani, El-Muxhadele: 19.

SHEJTANI ËSHTË ARMIKU KRYESOR I NJERIUT

jush armiqësi e urrejtje”.⁷

3. Ai mundohet që t'i bëjë besimtarët e mërzitur dhe të dëshpëruar. Allahu i Madhëruar thotë: “Intrigat e fshehta vijnë vetëm nga djalli, për t'i dëshpëruar besimtarët”.⁸

4. Shejtani e fton njeriun në mosbesim. Allahu (xh.sh) thotë: “Shejtani i thotë njeriut: “Mos beso!” Por, kur ky bëhet mohues, shejtani i thotë: “Unë nuk kam të bëj me ty! Në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve!”.⁹

5. Lakuriqësia. Çelësi me të cilin shejtani e filloi punën ishte lakuriqësia. Këtë qëllim e realizoi me babanë e njerëzimit Ademin (a.s) dhe me gruan e tij Havanë. Kur shejtani i mashtroi për të ngrënë pemën e ndaluar në të njëjtën kohë i mashtroi ata që të zbulojnë edhe pjesët e turpshme të trupit. Gjëja më e dashur për shejtanin është lakuriqësia. Jo më kot Zoti ia ka obliguar femrës muslimane mbulesën. Allahu (xh.sh) thotë: “Shejtani u pëshpëriti, për t'ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: “Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni melek ose të pavdekshëm”. Dhe iu betua atyre (duke thënë): “Vërtetë, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!”. Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit. Zoti i tyre i thirri: “A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se shejtani është vërtet armiku juaj i hapët?”.¹⁰

6. Shejtani frikëson por Allahu premtan. Në dhjetëra ajete kur'anore, Allahu (xh.sh) garanton furnizim, bollëk dhe na siguron me përcaktimin e rizikut. Vetëm në një ajet, shejtani frikëson me fukarallëk. Prandaj kujt duhet t'i besojmë? Krijuesit, Furnizuesit, Sunduesit, apo rrenacakut, mashtruesit? Allahu i madhëruar thotë: “Shejtani ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme. Kurse Allahu ju premtan faljen dhe mirësinë e Tij. Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshtëm”.¹¹ Allahu (xh.sh) thotë: “S'ka asnjë gjallesë në Tokë që

7. Kur'ani, El-Maide: 91.

8. Kur'ani, El-Muxhadele: 10.

9. Kur'ani, El-Hashr: 16.

10. Kur'ani, El-A'raf: 20-22.

11. Kur'ani, El-Bekare: 268.

të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij...”.¹²

Frika të robëron, prandaj prej metodave të shejtanit është frikësimi: Allahu i Lartësuar thotë: “Vetëm shejtani i frikëson ithtarët e vet. Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!”.¹³

7. Qëllimi i shejtanit është që t'ua zbukurojë njerëzve punët e këqija. Shejtani tha: “Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t'ua zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë”.¹⁴ Allahu (xh.sh) thotë: “Shejtani ju nxit vetëm në të këqija, në vepra të turpshme dhe të flisni për Allahun gjëra që nuk i dini”.¹⁵

“SHEJTANI JU FRIKËSON ME SKAMJE E VARFËRI DHE JU URDHËRON TË BËNI VEPRA TË PAMORALSHME. KURSE ALLAHU JU PREMTAN FALJEN DHE MIRËSINË E TIJ. ALLAHU ËSHTË MIRËBËRËS I MADH DHE I GJITHËDIJSHËM”

Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë) na këshillon me anë të një shembulli ku thotë: “O musliman! Bëhu sikur shpendi i cili fluturon, sa më lart tokës që të jetë ai, aq më të vështirë e kanë gjuetarët për ta quajtur atë. Gjithashtu afrohu edhe ti sa më afër qiellit (sa më afër Zotit) sepse shejtani e ka të vështirë për të gjuajtur shigjetat e tij tek ti”. Sa më shumë që të kapësh pas kësaj botë, aq më të lehtë e ka shejtani për të të sulmuar. Bëhu nga ata që rrinë afër Zotit me përmendjen e Tij dhe me kryerjen e obligimeve ndaj Tij.

Shejtani i mallkuar ka rrugë dhe metoda të ndryshme për të depërtuar tek njeriu, prandaj duhet të jemi vigjilent (syhapët) ndaj të gjitha intrigave të tij, duhet të kemi kujdes dhe t'ia mbyllim të gjitha dyert sepse ai menjëherë futet në atë derë dhe nuk largohet lehtë derisa ta bëjë të vetën.

SI TË MBROHEMI NGA SHEJTANI

Shkurtimisht po cekim disa ndër shkaqet më kryesore me të cilat njeriu mbrohet nga shejtani.

12. Kur'ani, Hud: 6.

13. Kur'ani, Ali Imran: 175.

14. Kur'ani, El-Hixhr: 39-40.

15. Kur'ani, El-Bekare: 169.

1. Kërkimi i mbrojtjes nga Allahu (xh.sh) prej shejtanit duke thënë Eudhu bilahi mine shejtani raxhim, siç thotë Allahu (xh.sh): “Nëse shejtani fillon të të joshë, kërko mbështetje tek Allahu”.¹⁶

2. Leximi i sureve Ihlas, Felek dhe Nas nga tri herë në mëngjes dhe në mbrëmje, siç ka thënë Pejgamberi (a.s): “Lexoje Kul huvallahu ehad dhe dy suret: Felek dhe Nas kur të zgjohesh dhe kur të gdhiesh (mëngjes dhe mbrëmje) nga tri herë, ato të mjaftojnë nga çdo gjë”.¹⁷

3. Leximi i Ajetit Kursij. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kur të shkosh për të fjetur lexoje Ajeti Kursij, do të kesh një roje nga Allahu dhe nuk do të afrohet shejtani derisa të zgjohesh (në mëngjes)”.¹⁸

4. Leximi i sures El-Bekare. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Mos i bëni shtëpitë tua varreza. Vërtet shejtani ikën nga ajo shtëpi në të cilën lexohet surja El-Bekare”.¹⁹

5. Leximi i dy ajeteve të fundit të sures El-Bekare. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush i lexon në mbrëmje dy ajetet e fundit të sures El-Bekare do t'i mjaftojnë (për atë natë)”.²⁰

6. Thënia e fjalës “La ilahe il-lallahu vahdehu la sherike leh, lekul mulku ve lekul hamdu ve huve ala kul'li shej'in kadir” njëqind herë në ditë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush thotë “la ilahe il-lallahu vahdehu la sherike leh, lekul mulku ve lekul hamdu ve huve ala kul'li shej'in kadir”, njëqind herë në ditë, do të ketë sevapin sikur të lirojë dhjetë robër, do t'i shënohen njëqind sevape, do t'i fshihen njëqind gjynahe dhe do të jetë i mbrojtur nga shejtani atë ditë deri në mbrëmje dhe nuk ka kush që ka bërë diçka (ndonjë vepër) më të mirë sesa ai përveç ai njeri që ka thënë më shumë sesa ai”.²¹

7. Përkujtimi i Allahut (xh.sh). Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Me përkujtimin e Allahut njeriu e mbron veten e tij nga shejtani”.²²

Allahu na ruajt nga sherri i shejtanit na mundësoftë të bëjmë punë të mira dhe na largoftë nga punët e këqija!

16. Kur'ani, Fussilet: 36.

17. Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu.

18. Buhariu nga Ebu Hurejra kur Pejgamberi (a.s) e la një natë roje dhe i erdhi shejtani në formën e një plaku për të vjedhur mall. Pasi e zuri atë Ebu Hurejra e kërcënoi se do ta dërgonte tek Pejgamberi (a.s) ai i tha: “Më liro se do të të tregoj diçka që nëse e thua, nuk do të të afrohet shejtani”. Ia tha këtë që cekëm më lart, që ta lexojë çdo natë kur të flejë.

19. Muslimi.

20. Buhariu.

21. Buhariu dhe Muslimi.

22. Ahmedi, Tirmidhiu, Ibn Huzejme dhe Hakimi.

21 SHTATOR, DITA BOTËRORE E PAQES!

*“ZOTI IM, TI JE BURIMI I PAQTIMIT,
PREJ TEJE BURON PAQJA...”!*

E lhamdulilah, unë jam musliman dhe bota është më e sigurtë! Kjo është esenca dhe zanafilla!

Pas çdo namazi, ne si muslimanë lexojmë dhikret e virdeve ditore që na i mësoi Resulull-llahu (a.s), ku fjalia e parë pas istigfarit është: “All-llahumme Entes-Selamu ve minkes-Selam...”, që do të thotë: “Zoti im, Ti je burimi i Paqtimit, prej Teje buron Paqja...”!

Me pak fjalë, më e pakta, pesë herë në ditë, Islami na edukon e na frymëzon drejt paqtimit dhe rrugëve të tij, duke u lartësuar ditë pas dite drejt asaj që Krijuesi ynë kërkon prej nesh në këtë jetë!

Le të punojmë me sa të kemi mundësi për të jetuar në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin, duke ruajtur mbi të gjitha dinjitetin dhe krenarinë e besimit dhe të fesë, shenjtërinë e jetës dhe atë të njeriut-mëkëmbës i Zotit në tokë, dijes dhe arsimit!

Të përpiqemi për të punuar me pastërti e dinjitet, të angazhohemi për të ruajtur e mbrojtur Tokën, nënën tonë të përbashkët, nga zjarret dashakeqe, nga shkatërrimet egoiste, që shpien drejt konflikteve dhe të papriturave të padëshiruara!

Të angazhohemi me të gjitha forcat për t'u ndarë nga politikat hipokrite e servile, që prishin rendin mbi tokë,

edhe duke përdorur kartën e fesë për të përçarë njerëzit mbi baza fetare, si një gangrenë e keqe, që është instaluar në mendësitë provinciale të mbështetura edhe nga rrogëtarë meskinë të tyre!

Të japë secili diçka nga vetja e tij për paqen me dinjitet, duke falur mirësi e dashuri, mirëkuptim e heshtje, sidomos në familje, me fëmijët, me të rinjtë e farefisin!

Nuk mund të prodhojmë paqe sociale, nëse nuk e kultivojmë dhe e jetojmë atë në familje fillimisht, pastaj në rrethin e ngushtë familjar, e më pas në shoqëri, me shumë kujdes e plot përkushtim!

Fjala e mirë është paqe! Buzëqeshja e sinqertë është paqe! Heshtja e urtë është paqe! Mësimi dhe edukimi i udhëzuar është paqe! Ndiurma në rast nevojë është paqe! Luftimi i së keqes në jetë është paqe! Kundërshtimi i keqpërdorimit të besimit është paqe! Përballja me tërë fenomenet e prishjes dhe devijimit është paqe!

Paqe me Zotin! Paqe me robin! Paqe me vetveten e me realitetet e përditshme, që gjithsesi mbeten më të dobëta sesa mundësia për të ndryshuar kaderin!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 21 shtator 2020



"BURRA, QË ISHIN TË SINQERTË NË ÇFARË I DHANË BESËN ALLAHUT!"

(Kur'ani, El-Ahzab: 23)



SHEH QAZIM HOXHA
(1893 - 1959)

"Baba, edhe në vaset që bënte, nuk merrej shumë me politikë. Ai fliste për udhëheqësin, por më tepër në raport të zgjedhjes së tij nga populli dhe obligimi i bindjes ndaj tij.

Një herë kujtoj mirë, se po lexonte në librin e famshëm të Imam Gazaliut "Ihja ulumiddin". Më thirri dhe më tha: Hajde, hajde Faik dhe lexo me mua. Në këtë gjendje jemi ne sot! Dhe lexoi këto varqe: "Fe lem ere dhulmen mithle dhulmin jenaluna – Jusau ilejna thumme nu'meru bish-shukri"*!

Pra, na bëjnë keq dhe na detyrojnë t'i falënderojmë. Në këtë gjendje kemi ardhur edhe ne sot, thoshte, që s'po lënë gjë pa na bërë dhe nuk jemi të zotë të hapim gojën!".

*Me përshtatje në shqip: "Nuk kam parë padrejtësi më të madhe se padrejtësia ndaj nesh – Na bëjnë keq dhe urdhërohem për mirënjohje!" - (Nga dëshmia e të birit, në monografinë me titull: Faik Hoxha para pasqyrës së një jete...)




H. FAIK HOXHA
(1930 - 2011)

Kujtoj një rast tjetër. Ishte Ramazan. I kisha porositur familjarët të më sillnin një lugë druri. Atje kisha një bidon alumini, ku përgatisja përsesh me çaj, të cilin e konsumoja në kohën e syfyrit, i shtrirë, për të mos u diktuar!

Ndërsa, kur vinte koha e iftarit, sidomos në ato vite kur koha e tij vinte pas vaktit të darkës, merrja një plasmë, bukën e ndaja kafshatë-kafshatë. Në atë kohë na nxirrnin për të parë lajmet e orës 20.00 dhe aty, nxirrja nga një kafshatë buke dhe me të bëja iftar! Ndërsa në mensë, ndërronim tasat me ndonjë prej shokëve dhe unë ngrihesha për ta larë tasin e tij bosh, duke dhënë për të kuptuar se kisha ngrënë!


Ndërsa kur vinte koha dhe mundësia për faljen e namazit, shpesh merrja ndonjë libër dhe e vendosja para syve, sikur po lexoja. Ndërsa jacinë e falja vonë. Sabahun e falja para se të bëhej zgjimi i të burgosurve. - (Nga monografia me titull: Faik Hoxha para pasqyrës së një jete...)



HAFIZ MUSA DËRGUTI
(1888 - 1961)

"Me akuzën "dijeni për Lëvizjen e Postribës", ishte arrestue edhe i forti hafiz Musa Dërguti, për të cilin do t'u fliste, se kur kishte qenë në një dhomë paraburgimi me Cjon Serreqin dhe i lidhun dorë për dorë me te, ishin pasë çue e ulë sëbashku si të kishin qenë një trup i vetëm, sa herë që gjatë ditës e natës t'i vinte vakti hafizit për me iu falë Zotit, si musliman e si hoxhë që ishte".

[Po ashtu i mbështjellë nofullash me shami për mungesë mjekre edhe plaku tjetër hafiz Musa Dërguti, që do kohë ma parë ia kishte la në qjak fytyrën një polici, kur ai i kishte pasë derdhë ujë e "abdesit" aty te truma, e që kur kishte kenë në Sigurim, i kishte pasë thanë një shoku të dhomës: "Më kërkojnë me folë për priftën, dojnë me na përça, e nesër me thanë se u pushkatuen priftënt me dëshmitë e hoxhallarëve. U kam thanë bani çka të doni, se atë punë s'e baj kurr"] - (A. Bushati, Në gjurmët e një ditari, Shkodër, 2007, f. 428).



HAFIZ SABRI KOÇI
(1921 - 2004)

"Me rastin e ditëlindjes së Hz. Muhammedit (a.s), organizoja ceremoni madhështore. Në një ceremoni të tillë, më kujtohet, patëm shkruar edhe parullën: "Mirë se erdhe i madhi Muhammed". Populli vazhonte pothuaj tërë natën me qëzim dhe hare, ashtu si nuk ishte parë ndonjëherë. Ndërkohë vijnë organet e punëve të brendshme. Zënë vend aty te altoparlanti dhe regjistrojnë tërë bisedën që bëra me atë rast. Më 1945. Kjo do të thotë se qysh më 45-tën u vura në shenjestrën e organeve të punëve të brendshme. Dhe, si përfundim, më marrin në pyetje duke më akuzuar se e lë popullin tërë natën atje dhe se e gjithë kjo shkonte në dëm të punës"

"Një ditë burgu, thuaj se një mijë vjet! Fillonte me një diktaturë të papërshtatshme. Po të dëgjoni se thua: "La ilahe il-lall-llah", atëherë mjerë ajo shpinë ç'ka hiqte..." - ("El-Hilal", Shkup, botim special, qershor, 1991, f. 10)

"Me 4 korrik 1966, në kohën kur po shkonte në xhami për faljen e ylesë, arrestohet dhe në shtator të atij viti dënohet me njëzet e tre vjet e pesë muaj burg, duke u liruuar më 22. 10. 1986." - (Dr. R. Zekaj, Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX, ribotim, Tiranë, 2002)



H. VEHBI S. GAVOÇI
(1923 - 2013)

"Jam munduar të bashkëpunoj me disa njerëz, për të shkruar sadopak në të mirën e fesë. Ndër artikujt e parë që kam shkruar është edhe "Asal-xhenneh" - (Shkopi i xhenetit), ku kam shkruar për Shoipërinë, vuajtjet që keni pësuar ju, vëllezërit e mi, pas vitit 1944.

I pari artikull i imi ka qenë për ju, për vendin tim. Pastaj, shumë kam shkruar për Shoipërinë nëpër revista, gazeta apo libra dhe jam munduar që të mos e harroj vendin tim, që më ka bërë nder të madh. Këtë e kam bërë që t'ia kthej atë nder të madh vendit tim me plot respekt.

Shkova në Kosovë, në vitin 1974. Besimtarët atje u interesuan shumë për mua dhe më pritën shumë mirë. Mendova se çfarë t'u jap si falënderim? Iu përvësua punës dhe botova një libër të titulluar "Si dhe pse?" dhe iu thashë: "Në vend që t'ju falënderoj me fjalë, po e bëj me vepra duke iu dhuruar këtë libër në besimin e Zotit dhe adhurimin e Tij". E kemi shtypur dhe është shpërndarë edhe në vendin tonë, më pas". - (M. Sytari, Vehbi Sulejman Gavoçi- Dijetar nga dijetarët e ymetit, Prishtinë, 2005)



HAFIZ IBRAHIM REPISHTI
(1883 - 1943)

"Nji mesnatë, nji bastisje nga policia fashiste tronditi qjumin e oetsinë e familjes sonë. Të rreshtuem me shpinë për mur, prindë e fëmijë ndoqëm me frikë në zemër lëvizjet e randa e të zhurmshme, si dhe shamjet e papushim të aqjentëve t'armatosun, që silleshin poshtë e nalt, tue kërkue në çdo vrimë të shtëpisë, diçka që nuk e gjejshin.

Për ma shumë se një orë, në rrobe qjumi, - ata nuk na dhanë as kohë me u veshë, - pritëm përfundimin e "operacionit". Nji oficer mori babën për krahu me forcë e, me nji të shtyme, e vunë në nji dhomë tjetër. Nuk ndiqjem fjalë, vetëm britmat e ushtarakut. Zani i babës nuk arriti në veshët tonë. Pak ma vonë, - për ne qe nji kohë e pafund, - baba u kthye përsëri rranzë murit pranë nesh, pa fjalë, por qartësisht i tronditun: duket se e kishin keqtrajtuar fizikisht. Nana e na fëmijët e shikjojshim pa fjalë e me frikë.

Prindët na përfaqëuan e na përcoollën në shtretin tonë. Por në dhomën e fjetjes së prindërve, drita nuk u shue. Baba nuk fjeti. Atë natë, n'orët e para të mëngjesit, u zgjuem papritë nga thirrjet trishtuese të nanës në panik. Në dhomën e tij shtrihej baba, gjysëm i paralizuem nga nji hemorragji cerebrale. Pak ditë ma vonë, ai dha shpirt."

(S. Repishti, Pika loti, Tiranë, 2007)

ALGJERIA

OSE REPUBLIKA DEMOKRATIKE POPULLORE E ALGJERISË

Republika Demokratike Popullore e Algjerisë, ose Algjeria, është vend arab që gjendet në veri të kontinentit afrikan. Ky vend kufizohet me Detin Mesdhe në veri, me Mbretërinë e Marokut në perëndim, me Saharanë Perëndimore, Mauritininë dhe Malin në jugperëndim, me Nigerinë në juglindje, me Libinë në lindje, dhe me Tunizinë në veri-lindje.

Algjeria ka një sipërfaqe prej 2.381.741 km², që e bën vendin me sipërfaqen më të madhe ndër vendet e Afrikës, dhe renditet i dhjeti në rang botëror. Popullsia e Algjerisë shkon në 44.034.567 banorë, sipas Worlmetr (shtator, 2020).

Qytetet më të mëdha në vend janë Algjeri, Veheran dhe Kasantina. Kryeqyteti i vendit është Algjeri, qyteti i cili ndodhet në pjesën veriore të vendit.

Në veri, Algjeria përbëhet nga fusha të gjera bregdetare, që shtrihen pranë Detit Mesdhe zonë e cila përfshin 70% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Toka e Algjerisë në jug, është një shkretëtirë e gjerë, me shumë oaze. Vendi gjithashtu ka edhe vargmale,



XHAMIA UKBE IBN NAFI, ALGJER

nga të cilët më të rëndësishmit janë vargmalet Atlas Et Tel'l, të cilat shtrihen paralele me fushat bregdetare, si edhe Malet Atlas të Saharasë, që shtrihen në drejtim të jugut, ku ndodhet edhe maja më e lartë në Algjeri, maja e Tahatit, me një lartësi 3.303 metra.

Lumi Shlif është lumi më i gjatë në Algjeri, rreth 700 kilometra, që buron nga malet e Atlasit Saharian, afër qytetit Eflu, vazhdon rrjedhjen përmes maleve Atlas Et-Tel'l, pastaj derdhet në Detin

Mesdhe, në veri të qytetit Mistganem.

Algjeria karakterizohet nga lugina, të cilat gjatë dimrit mbushen me ujë, pastaj kullojnë duke u kthyer në kullota pjellore, ose bëhen pellgje të mbyllura, të njohura si Shat'te, nga të cilat më të rëndësishmet janë Shat't El Hodna dhe Melgig.

Në jug të Algjerisë ka shumë oaze, ku më të famshmit janë Tagit, Uirgle dhe Ihrir.

KLIMA

Algjeria Veriore karakterizohet nga klima mesdhetare, me dimra të butë dhe relativisht me shi, dhe temperatura që ndryshojnë midis 21-24 °C në verë, dhe 02-12 °C në dimër. Në zonat malore të vendit bie shi më pak se në veri dhe dimri atje është me borë, me një të ftohtë ku ndonjëherë temperatura shkon nën zero, kurse gjatë verës mbizotëron klima e nxehtë dhe e thatë. Jugi i vendit karakterizohet nga klima e shkretëtirës, ku gjatë verës temperatura shkon në mbi 50°, kurse netët janë të freskëta.

EKONOMIA

Algjeria është klasifikuar nga Banka Botërore si një vend me të ardhura mesatare. Në Algjeri më së shumti kultivohen drithërat, gruri, palmat, hardhitë, agrumet, ullinjë, rrushi, qepët, karotat, elbi dhe duhani. Bagëtitë rriten në një numër të madh, ku përfshihen delet, dhitë, lopët dhe në një masë shumë të madhe edhe devetë. Nafta dhe gazi natyror përbëjnë pasurinë kryesore të vendit, ku gazi natyror i lëngshëm përbën

UNIVERSITETI I SHKENCAVE ISLAME - ALGJER



një nga burimet më të rëndësishme të pasurisë kombëtare. Ndër degët më të rëndësishme të industrisë në Algjeri janë industria e përpunimit të naftës, industria e tekstileve, ushqimit, çimentos, e materialeve të ndërtimit, industria e prodhimit të makinerive bujqësore, veturave, pajisjeve elektronike, etj, kurse prodhimet që eksporton më shumë janë: nafta, gazi, hekuri, çeliku, fosfatet, bakri, vajrat, hurmat, pemët dhe perimet, pjesët e këmbimit, çimentoja, materialet e ndërtimit, etj.^[1]

GJUHA

Gjuha Arabe është gjuha zyrtare e Algjerisë, përveç gjuhës Frënge që konsiderohet gjuhë e dytë dhe që e zotërojnë shumë algjerianë. Një e pesta e popullsisë flasin gjuhën amazige (në shumë rajone të Algjerisë) dhe dialektet e tyre ndryshojnë nga një rajon në tjetrin.

FEJA

Islami është feja shtetërore e Algjerisë, me kushtetutë dhe myslimanët përbëjnë 99% të popullsisë, ku shumica e tyre i përkasin Islamit Sunit (Medhhebi Malikij). Megjithatë, aty gjenden edhe Kishat Katolike Romake, dhe jomyslimanët që banojnë në Algjeri vlerësohen të jenë më pak se 5.000 njerëz.^[2]

HISTORI

Algjeria është një vend mbi të cilin kanë kaluar shumë civilizime, duke e bërë atë të trashëgojë një histori të pasur. Në shkrimin e historisë së saj kanë ndikuar Afrika, Mesdheu, Evropa edhe Levanti. Mbetjet e para

arkeologjike të dukshme, janë ato të mbetura në Parkun Kombëtar të Tassili, i cili konsiderohet si muzeu më i madh i hapur, në botë. Mauzoleumët janë të përhapur në disa rajone të vendit, të tilla si Imdgassen (shek. 3-të p.e.s), mauzoleumi mbretëror i Mauritinisë, si dhe zona arkeologjike e mauzoleumit të mbretit legjendar numidian Massinissa, afër qytetit Sirta (vilajeti i Kasantinës), e shumë objekte të tjera dhe mauzoleume që dëshmojnë për metodat dhe ritet funerale.

Periudha romake la shumë monumente historike në Tibaze, Tinkad, Nakus, Khamis, Kalma, etj.

Pas ardhjes së Islamit në Afrikën Veriore, rajoni dëshmoi zhvillimin e shumë qyteteve algjeriane, të tilla si qytetet Tilmisan, kryeqyteti Algjer, Bixhaje, e duke e vazhduar këtë traditë edhe më tej shumë dinasti të tjera që erdhën më pas, të cilat u bënë dinastitë sunduese në disa rajone të Algjerisë.

Në vitin 1515 (e.j), Osmanët e futën Algjerinë nën perandorinë e tyre, pastaj në 1830 vendin e morën Francezët, deri kur u çlirua përfundimisht dhe fitoi pavarësinë, në vitin 1962.



OAZI IHRIR

SI HYRI ISLAMI NË ALGJERI

Algjeria në të kaluarën konsiderohej si pjesë e vendeve të Magribit musliman, ku fjala "Magrib" do të thotë "Perëndim". Historianët e lashtë, gjithë zonën në perëndim të Egjiptit e kanë quajtur "Magrib", dhe e kishin ndarë atë zonë në tre rajone kryesore:

1- Magribi (perëndimi) i Afërt, që përfshinte atë zonë, që ata e quanin Afrikja, qendra e të cilit asokohe ishte qyteti Kajravan. Ky rajon përfshinte disa qytete, si qytetet: Baxhe, Bune, Bizerte, Kastila, Sfax, Kafsa, Tunis, Susse, dhe qytete të tjera.

2- Magribi i Mesëm, shtrihej nga Bexhaje, deri në Luginën Meluije dhe qendra e tij ishte qyteti Tilmisan, e përfshin disa qytete, si: Tenes, Xhixhel, El-Kal'a, El-Mesila, Tabna, Melila, edhe qytete të tjera, dhe Algjeria e sotme bën pjesë në këtë zonë.

3- Magribi i Largët, shtrihej nga Lugina Meluije dhe Malet Taza, deri në Oqeanin Atlantik dhe qendra e tij ishte qyteti Fas, pastaj Marrakish dhe përfshinte disa qytete, si: Fas, Meknasa, Sele dhe Der'a.

Luftimet e muslimanëve për të marrë zonën e Magribit vazhduan afërsisht shtatëdhjetë vjet, duke filluar nga viti 27 i hixhretit, e deri në vitin 90 i hixhretit (viti 709).

Kështu, Algjeria u mor nga muslimanët gjatë kësaj periudhe, nën komandën e komandantit Ukbe ibn Nafia, pastaj nën komandën e Zuhejr ibn Kajs, pastaj të Has'san ibn Nu'man. Më pas luftimet e muslimanëve për marrjen nën kontroll të gjithë Magribit vazhduan nën komandën e Musa ibn Nasir. Zoti i mëshiroftë të gjithë, dhe i pranoftë në mesin e dëshmorëve!^[3]

Algjeria është vend anëtar themelues i Organizatës Arabe të Magribit, e cila u themelua në vitin 1988, është vend anëtar i Lidhjes Arabe dhe vend anëtar i Kombeve të Bashkuara, që nga pavarësia e saj. Gjithashtu Algjeria është vend anëtar i Organizatës së Unionit Afrikan, si dhe i shumë institucioneve globale dhe rajonale.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

- <https://www.marefa.org>
- <https://www.encyclopedia.com/places/africa/algerian-political-geography/algeria>
- <https://www.islamweb.net/ar/fatwa/28573>

MYFTIU PRITI AMBASADOREN E SHBA-SË NË TIRANË, ZNJ. YURI KIM



Paraditën e së xhumasë, më 11 shtator 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt ambasadore e ShBA në vendin tonë, znj. Yuri Kim.

Në një postim në profilin e tij zyrtar në fb, Myftiu shkruan: “Ditën e sotme, prita në një takim kortezie, ambasadore e ShBA në vendin tonë, znj. Yuri Kim, me të cilën ndamë

mendime rreth besimit, dijes, urtisë e historisë, kulturës e trashëgimisë, vlerave të lirisë së besimit, shenjtërisë së jetës dhe respektimit të drejtave legjitime të tjetrit, kushdo qoftë ai!

Shkodra, me elementët e saj përbërës, besimin, qytetarinë, diversitetin fetar e kulturor, trashëgiminë e vlerave, personalitetet emblematiche, datat e shënuara dhe shpirtin e harmonisë, përtej tekave provinciale, ishte pjesë

e rëndësishme e bashkëbisedimit tonë.

U takuam dhe u ndamë në kufijtë e të bardhës, mesazheve të paqes e domosdoshmërisë së ruajtjes me dinjitet e krenari të besimit e fesë, urave që lidhin njerëzit e pjekur e vullnetmirë, dhe përkushtimit në rrugën e shërimit të lëngatave të mëdha që kanë pezmatuar shoqëritë e sotme njerëzore, atë shqiptare në veçanti!”.

MYFTIU UROI PËR FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR 2020-2021

Paraditën e së hënës, më 14 shtator 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia”, ku uroi drejtorin Kujtim Dervishi me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2020-2021.

Në kushtet e reja të imponuara nga e quajtura pandemia e covid-19, viti i ri shkollor ka nisur në kushte të ndryshme nga ato të viteve të kaluara, sipas disa udhëzimeve të caktuara nga institucionet e arsimit.

Myftiu uroi drejtorin e Medresesë për një vit sa më të mbarë në rrugën e sukseseve, siç jemi mësuar prej dekadash me arritjet e medresesë sonë.

Nga ana e tij, drejtori i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, z. Kujtim Dervishi e informoi Myftiun për detajet e nisjes së vitit të ri shkollor dhe angazhimin



maksimal për realizimin e objektivave të planifikuara, me gjithë vështirësitë që krijoi gjendja në kushtet e reja.

Myftinia Shkodër uron nxënësit e Shkodrës për një vit shkollor plot suksese dhe mbarësi, pa dëme e vështirësi!

ATY KU NDËRTOHET NJË XHAMI, ATY ËSHTË NJË GJURMË E RRËNJOSUR E QABES SË MADHNUESHME!

Pas shumë përpjekjesh të Myftinisë Shkodër, në bashkëpunim me Fondacionin “Komiteti i Bashkuar Kuvajtian”, pas miratimit të dhënë nga Kryesia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, dakortësisë së Zyrës së Administratorit të Njësisë Administrative Dajç dhe dhurimit të vakëfit nga i nderuari z. Hamza Vera, sot bëjmë piketimin e kibles dhe përgatitjet e para për xhaminë e re.

Ky është një lajm i begatë për shumë e shumë muslimanë të një zone, thuajse të aneksuar, që prej dekadash kryejnë ritet e tyre në një ambient tejet të amortizuar. Sa e sa herë kemi marrë kërkesa nga ata besimtarë të mirë e besnikë për ndërhyrjen a gjetjen e një

aty është një hise e Kubasë Sherife dhe Xhamisë së Resulull-llahut (a.s)!

Prandaj ta falënderojmë All-llahun e Madhëruar për këto mirësi, me të cilat na dëshmon mëshirën dhe kënaqësinë e Tij! Sepse aty ku ndërtohet një xhami, aty në fakt, leja fillestare është ajo e Vetë Krijuesit të gjithësisë, që me bekimet e Tij ka lejuar që një Shtëpi prej shtëpive të Tij të ngrihet në atë cep të tokës së Tij! Urdhëron: “Dritë mbi dritë. All-llahu udhëzon nga drita e Vet atë që do Ai. All-llahu sjell shembuj për njerëzit. All-llahu çdo gjë di shumë mirë. (ajo dritë) Është në shtëpitë (xhamitë) që All-llahu lejoi të ngrihen, e që në to të përmendet emri i Tij, t’i bëhet lutje Atij mëngjes e mbrëmje.” – (Kur’ani, En-Nur: 35-36).



zgjidhjeje, dhe ja, durimit të tyre po i vjen kjo dhuratë e madhe e Krijuesit të gjithësisë.

Në pamundësi për të marrë pjesë fizikisht, për shkak të udhëzimit mjeksor për të pakësuar maksimalisht lëvizjet, jam i detyruar sot, ta bëj këtë urim nga kjo tribunë, duke u lutur me zemër që kjo datë, që përkon me 30 vjetorin e rihapjes së xhamisë së parë pas periudhës së errët, si edhe me fillimin e muajit të ri Safer 1442, të mbahet mend si datë e gëzueshme për të gjithë ne!

Aty ku ndërtohet një xhami, aty është një gjurmë e rrënjosur e Qabes së Madhnueshme të Hz. Ibrahimit (a.s) e Hz. Ismailit (a.s),

Një falënderim i madh, shoqëruar me mirënjohje të thellë për bamirësit zemërgjerë nga Shteti i Kuvajtit, bamirësia e të cilit ka prekur çdo cep të botës, duke u bërë dëshmitari më i mirë se si ndarja e pasurisë me vëllezërit e tu dhe solidarizimi me tjetrin, jo vetëm që të pasuron, por të lartëson në pozitë më të larta të kësaj bote dhe të përtejmes!

Me zemër të mirë e me begati për muslimanët e Rrushkullit, për zonën e Shkodrës, për Myftininë tonë dhe për krejt besimtarët, që gëzojnë për këtë myzhde të madhe!

Imam Muhamed B. Sytari

*Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 18 shtator 2020*

NISIN PUNIMET PËR NDËRTIMIN E XHAMISË SË RE NË FSHATIN RRUSHKULL-BELAJ

Paraditën e së xhumasë, më 18 shtator 2020, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin “Komiteti i Bashkuar Kuvajtian”, pas miratimit të dhënë nga Kryesia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pëlqimit të Zyrës së Administratorit të Njësisë Administrative Dajç dhe dhurimit të vakëfit nga i nderuari z. Hamza Vera, bënë piketimin e drejtimit të kibles dhe nisën punimet e para përgatitore për xhaminë e re në fshatin Rrushkull-Belaj.

Në emër të Myftinisë Shkodër përshëndeti teologu Lavdrim Hamja, i cili përcolli selamet dhe përshëndetjet e përzemërta të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili për arsye shëndetësore e kishte të pamundur të merrte pjesë në këtë ceremoni të begatë të piketimit të drejtimit të kibles dhe punimeve përgatitore për ndërtimin e xhamisë së re.

Teologu Hamja falënderoi të gjithë ata, të cilët u bënë shkak për ndërtimin e kësaj xhamie, veçanërisht dhuruesin e tokës ku do të ndërtohet xhamia, donatorin “Humanitarian Relief Society – Kuwait”, Fondacionin “Komiteti i Bashkuar Kuvajtian”, që do të zbatojë projektin e ndërtimit të xhamisë xhamisë, popullin kuvajitian, të cilët vazhdimisht po kontribuojnë për Shqipërinë dhe popullin shqiptar, banorët e fshatit, si dhe imamin e xhamisë së fshatit Rrushkull, H. Suad Lekaj dhe H. Kujtim Cufaj imam i fshatit Shirq, por që më parë ka shërbyer në këtë fshat.

Në emër të Fondacionin “Komiteti i Bashkuar Kuvajtian” përshëndeti z. Elton Beka, ku falënderoi Myftininë Shkodër, për gatishmërinë dhe bashkëpunimin e frytshëm në ndërtimin e xhamive në Zonën e Shkodrës, donatorët dhe banorët e zonës, që ishin të pranishëm në këtë ceremoni.

Myftinia Shkodër lutet që All-llahu i Madhëruar t’i shpërblejë të gjithë me të mira e begati, kudo qofshin ata, të cilët kontribuojnë dhe ndërtojnë xhami e projekte bamirëse në shërbim të komunitetit.

Mbrëmjen e së shtunës, më 26 shtator 2020, në vazhden e ciklit të ligjëratave me temë: “Xhamia na mbledh, drita e All-llahut na udhëzon!”, u mbajt ligjëratat me temë: “Falënderimi dhe mirënjohja ndaj Zotit”, nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Në ligjëratën e mbajtur pas namazit të akshamit në xhaminë e Muriqanit, Ana e Malit, Myftiu i Shkodrës shprehu në krye të herës falënderimet dhe vlerësimin e tij për imamët e nderuar të zonës për punën e palodhur dhe kontributin për gjallërimin e jetës fetare e kulturore, nëpërmjet aktivitetit të xhamisë dhe me komunitetin e gjerë.

Myftiu ligjëroi rreth temës së mirënjohjes ndaj Zotit në jetën e përditshme, ku vuri theksin tek disa argumente që na ftojnë të meditojmë rreth mirësive pa fund, me të cilat, All-llahu i Madhëruar e ka zbukuruar jetën tonë, si: siguria, shëndeti, ushqimi, etj.

Myftiu vuri theksin tek domosdoshmëria e respektimit të mirësive të Zotit në jetë

MBRËMJE FETARE NË XHAMINË E MURIQANIT



dhe kthimit përherë tek sekretet e besimit, që i dhurojnë njeriut paqen e brendshme dhe rehatinë e shpirtit.

Ai theksoi se edhe vetë falënderimi, me të cilin besimtari i shpreh mirënjohjen e tij All-llahut (xh.sh), është mbarësi nga

vetë Zoti për njeriun, si për t'i thënë: “Unë dua ta dëgjoj zërin tënd duke më falënderuar!”.

Cikli i ligjëratave javore do të vijojë edhe në xhami të tjera të qytetit dhe të fshatit.

“JETA E PEJGAMBERIT (A.S), RËNDËSIA E STUDIMIT TË SAJ NË AKTIVITETIN E THIRRËSIT ISLAM”



Paraditen e së hënës, më 28 shtator 2020, u zhvillua takimi i pestë i trajnimit 10 javor me imamët e Myftinisë Shkodër.

Ligjëratat e kësaj dite u mbajt nga teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, i cili trajtoi temën me titull: “Jeta e Pejgamberit (a.s), rëndësia e studimit të saj në aktivitetin e thirrësit islam”.

Gjatë trajtimit të kësaj teme, imami i nderuar vuri theksin tek domosdoshmëria e njohjes së mirë dhe studimit në detaje të Jetës Profetike për thirrësin islam, i cili ka mbi supë një barrë të rëndë, në

shërbim të komunitetit dhe në përpjekjet e vazhdueshme për të paraqitur vlerat e Thirrjes Islame me uredi e korrektësi.

Duke sjellë shembuj konkretë nga jeta e të Dërguarit të All-llahut (a.s), teologu Hamja shpjegoi se si metoda e thirrjes islame mundet të japë frytet e saj duke u bazuar pikërisht tek metoda e Pejgamberit (a.s) në kumtimin e Shpalljes dhe përhapjen e Islamit. Sepse, qëllimi i studimit të Jetës Profetike është, që mësuesi dhe thirrësi islam të kenë shembull të gjallë, të Dërguarin e All-llahut, në rrugën e tyre të edukimit dhe të thirrjes islame.

Më pas, aktiviteti pasoi me ndërhyrjet, pyetjet dhe sugjerimet nga imamët e pranishëm.

Gjithashtu, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pasi falënderoi ligjëruesin, solli disa mendime me vlerë rreth domosdoshmërisë së leximit dhe mirëkuptimit të jetës së Resulull-llahut (a.s) nga dijetari dhe studiuesi i mirënjohur damasken, Dr. Mervan Shejkhulerd.

Ai njëkohësisht dha disa këshilla që kanë të bëjnë me aktivitetin e imamëve dhe frymën e bashkëpunimit, bazuar mbi frymëzimet që jep studimi i biografisë së Hz. Muhamedit (a.s).

MEJTEPI I IM... XHAMIA E KALASË SË DRISHTIT

PAK HISTORI:

- Xhamia e kalasë së Drishtit, ndodhet në Njësinë Administrative Postribë, zona Shkodër.

- Lagja e kalasë së Drishtit, me status zonë turistike dhe me histori të lashtë përbëhet prej tre fiseve myslimane. Fiset më të njohura janë: Muhaj, Buhaj dhe Faca.

- Kohët e fundit, xhamia e kalasë së Drishtit është rikonstruktuar në vitin 2015 me mbështetjen financiare të disa donatorëve turq, përmes shoqatës “Istanbul”. Përpara saj, ka funksionuar për adhurim xhamia e vjetër, e cila është rihapur në vitin 1991.

- Në xhaminë e kalasë së Drishtit deri në vitin 1967 (viti famëkeq i privimit nga liria fetare) kanë shërbyer si imamë dhe mësues të mejtepeve: Sait Hoxha, Zenel Cukali, Hysen



Komi, Abdyl Kullolli, Isuf Neziri, Hafiz Ymeri (nga Kosova) dhe Maliq Trashuka.

Ndërsa, pas rihapjes së kulteve fetare dhe lirisë fetare, nga viti 1991 e deri më sot kanë shërbyer si imamë dhe mësues feje: Muhamed Shabaj, Nexhmi Guri, Astrit Muhaj, Astrit Shabani, Isa Muhaj (imami aktual).

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 12 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 - 2020 është rreth 115 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Spektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër në kuadër të programit për zhvillimin e vizitave

dhe takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni organizoi takimin e radhës, pas xhumasë, më 04 shtator 2020 me nxënësit e kursit fetar në xhaminë e kalasë së Drishtit.

Fillimisht teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimit e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi arsimit foli edhe për respektimin e rregullave gjatë procesit mësimor kundër përhapjes së koronavirusit/ covid-19 si dhe evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi dhe imami H. Isa Muhaj.



SHOQATA MIQËSISË SHQIPËRI-VENDET ARABE ZHVILLON AKTIVITET PËR DY RILINDËS TË MËDHENJ!

Më 17 shtator 2020, në oborrin e ish shtëpisë së Filip Shirokës, shoqata Miqësisë Shqipëri-Vendet Arabe, zhvilloi një veprimtari me vlera shkencore dhe kulturore në përkujtim të 195 vjetorit të lindjes së Pashko Vasës dhe 80 vjetori i vdekjes së Filip Shirokës.

Në këtë veprimtari morën pjesë intelektualë, historianë, mësues dhe anëtarë të shoqatës.

Referatat e kësaj veprimtari u mbajtën nga z. Muamer Vuci, kryetar i shoqatës Miqësisë Shqipëri-Vendet Arabe dhe nga historiani, z. Kujtim Shima.

Temat me vlerë, që u mbajtën nga të dy referuesit, tërhoqën vëmendjen e të pranishmëve dhe u përcollën edhe nga mediat lokale.

Një koïncidencë historike, të dy këto personalitete të rilindjes sonë, u arsimuan në Itali dhe punuan së bashku në vendet arabe, ku u pritën ngrohtësisht



dhe u respektuan për punën e tyre. Padyshim, si Filip Shiroka ashtu edhe Pashko Vasa flisnin mirë gjuhën arabe dhe komunikonin me vendasit në gjuhën arabe.

Të dy këta rilindës u varrosën në

Bejrut dhe përsëri u rivarrosen në vendlindjen e tyre, Shkodër.

Në përfundim të kësaj veprimtarie, doli në konkluzion, se duhet bërë shumë më tepër për vlerësimin e kontributit të dy këtyre burrave të mëdhenj!

THEMELOHET KOMUNITETI MUSLIMAN SHQIPTAR NË ZVICËR

Në pasditen e së dielës, më 20.09.2020, në xhaminë shqiptare në Regensburg, u mbajt Kuvendi i përbashkët i dy organizatave islame shqiptare, UBISHZ dhe BISHZ, me ç'rast kuvendarët dhe delegatët e rreth pesëdhjetë xhamive që prezantuan, në krye me dy kryesitë dhe përfaqësuesit e tyre, Hfz. Mehas ef. Alija dhe Fehim ef. Abazi, miratuan vendimin për bashkimin e tyre dhe formimin e organizatës së vetme fetare islame shqiptare në Zvicër, Komunitetin Musliman Shqiptar në Zvicër.

Kjo u realizua në një atmosferë vëllazërore, në prezencë të një numri të madh delegatësh, përfshirë kryetarë dhe anëtarë të kryesive të xhamive, së bashku me imamët e tyre, të cilët kishin ardhur nga të gjitha rajonet ku janë xhamitë shqiptare në Zvicër.

Gjithashtu, përveç

disa vendimeve dhe miratimeve të rëndësishme që u morën në këtë mbledhje, u miratua vendimi që kryesia e re të formohet nga dy kryesitë e mëparshme, në krye të së cilës u zgjodh unanimisht, hfz. Mehas Alija.


Takimi përfundoi me faljen e namazit të akshamit, me ç'rast, pas namazit, xhamia nikoqire shtroi edhe një darkë solemne për të gjithë pjesëmarrësit në Kuvend.

Komuniteti Musliman Shqiptar në

(www.daigs.ch)



TË REJA RRETH KRYERJES SË UMRES



Autoritetet saudite bënë të ditur, të martën, më 22 shtator 2020, rikthimin e përshkallëzuar të Umres, pas një ndalese rreth 7 muaj, duke nisur fillimisht me shtetasit sauditë dhe rezidentët në Mbretërinë Saudite, nga data 4 tetor 2020.

Më pas nis pritja e atyre që dëshirojnë të kryejnë Umren nga vendet e tjera të botës, nga fillimi i nëntorit 2020, sipas një plani në katër faza, që përkon edhe me masat shëndetësore për ndalimin e përhapjes së virusit korona.

PALLATI TOPKAPI ËSHTË NJË PREJ PALLAT-MUZEVE MË TË MËDHENJ NË BOTË?

Pallati Topkapi filloi të ndërtohet në vitin 1460 me urdhrin e Fatih Sulltan Mehmetit (Sulltan Mehmet II) pas ngadhënjimit të Stambollit dhe përfundoi në vitin 1478. Pallati ndodhet në gadishullin historik të Stambollit mes Detit Marmara, Ngushticës së Stambollit (Bosfor) dhe Haliçit (Briri i Artë) dhe ai jo vetëm që ka qenë qendra administrative, arsimore dhe artistike e Perandorisë Osmane për rreth 400 vjet, por njëherësh ka qenë edhe shtëpia e sulltanëve.

Në fillim të viteve 1850, pasi pallati aktual ishte i pamjaftueshëm për të siguruar nevojat e protokollit shtetëror

të shekullit të 19-të, u ndërtuar Pallati Dolmabahçe dhe pas një kohe jeta dhe qendra administrative e dinastisë u transferua plotësisht në Dolmabahçe.

Pas heqjes së monarkisë osmane në vitin 1922, me direktivën e Mustafa Kemal Atatürk, më 3 prill 1924 Pallati Topkapi u kthye në muze dhe ai ka veçorinë e muzeut të parë të Republikës së Turqisë.

Me arkitekturën, koleksionet dhe rreth 300 mijë dokumente arkivore Pallati Topkapi është një prej pallat-muzeve më të mëdha në botë.


(www.trt.net.tr)



DIJETARËT ISLAMË DËNOJNË RIBOTIMIN E KARIKATURAVE ANTI-ISLAME

Unioni Botëror i Dijetarëve Muslimanë dënoi sot ribotimin karikaturave fyese të Profetit Muhamed nga ana e revistës satirike franceze Charlie Hebdo, transmeton Anadolu Agency (AA).

“Ata që fyejnë Profetin Muhamed, i cili predikoi mirësi, drejtësi dhe liri, nuk kanë asnjë moral dhe nder”, tha Ali Al-Karadaghi, sekretari i përgjithshëm i Unionit.



Në deklaraten e publikuar në gjuhën arabe, thuhet se revista ka ekspozuar përsëri moralin e vërtetë të shoqërisë së saj dhe se dëshiron të ri-interpretojë konceptet e sekularizmit, të drejtave të njeriut dhe lirisë.

Al-Karadaghi tha se muslimanët nuk do t'i përgjigjen injorancës së tillë me injorancë, duke theksuar se as revista dhe as drejtuesit e revistës nuk mund të kuptojnë kurrë statusin e çmuar të Profetit Muhamed.

Ai tha se muslimanët janë mbrojtës të mirësisë dhe ideve të drejta, jo të së keqes dhe besojnë në respektimin e shenjtërisë së të gjitha besimeve fetare.

Pavarësisht kritikave dhe dënimeve, revista franceze ka botuar karikatura që fyejnë Islamin dhe Profetin Muhamed disa herë që nga viti 2006.

(www.aa.com.tr)

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

*"Kërkimi i diturisë
është detyrë për çdo mysliman!"*

(Transmetuar nga Ibn Maxheh dhe Bejhakiu)



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org